



KOMISIONI RREGULLATOR  
I ENERGJETIKËS DHE I SHËRBIMEVE TË  
UJIT  
TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË  
VERIUT



**NJOFTIM PËR OPINIONIN**

Komisioni Rregullator i Energjetikës dhe i Shërbimeve të Ujit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, solli vendim, me të cilin kryhet **ulja e çmimeve të shitjes me pakicë të derivateve të naftës mesatarisht për 1,03 %** në raport me vendimin e datës 15.11.2021.

Çmimi i shitjes me pakicë i **EURODIZELIT (D-E V) ulet për 1,50 denarë/litër**, ndërsa çmimet e shitjes me pakicë të benzinës **EUROSUPER BS-95 dhe EUROSUPER BS-98 nuk ndryshojnë.**

Çmimi i shitjes me pakicë i **Vajit Ekstra të Lehtë për Amvisëri (EL-1) ulet për 1,00 denarë/litër.**

Çmimi i shitjes me pakicë i **Mazutit M-1 SU ulet për 0,607 denarë/kilogram dhe tani do të jetë 41,245 den/kg.**

Nga data 23.11.2021, ora 00:01 çmimet maksimale të derivateve të naftës do të jenë:

|                           |                                |                                 |
|---------------------------|--------------------------------|---------------------------------|
| <b>Benzinë për motorë</b> | <b>EUROSUPER BS - 95</b>       | <b>75,00 (denarë/litër)</b>     |
| <b>Benzinë për motorë</b> | <b>EUROSUPER BS - 98</b>       | <b>77,00 (denarë/litër)</b>     |
| <b>Naftë për motorë</b>   | <b>EURODIZEL BS (D-E V)</b>    | <b>66,50 (denarë/litër)</b>     |
| <b>Vaj për Djegie</b>     | <b>Ekstra i Lehtë 1 (EL-1)</b> | <b>66,00 (denarë/litër)</b>     |
| <b>Mazut M-1 SU</b>       |                                | <b>41,245 (denarë/kilogram)</b> |

**Në periudhën e kaluar shtatëditore çmimet referente në bursat botërore mesatarisht shënojnë ulje: te benzina për 1,511 %, te nafta për 4,234 %, te vaji ekstra i lehtë për 4,294 % dhe te mazuti për 3,366% .**

**Në të njëjtën periudhë kursi i denarit në raport me dollarin është më i lartë për 1,356%.**

Theksojmë se këto janë çmimet maksimale të derivateve të naftës nga ora 00:01 e datës 23.11.2021. Tregtarët me shumicë dhe pakicë me derivate të naftës dhe lëndë djegëse për transport, mund t'i formulojnë çmimet e derivateve të ndryshme të naftës dhe lëndëve djegëse për transport edhe më të ulëta se çmimet më të larta që janë përcaktuar.

Çmimet e shitjes me pakicë të EURODIZELIT dhe të EUROSUPERIT BS – 95 në Maqedoninë e Veriut dhe në disa vende të UE-së ([https://ec.europa.eu/energy/data-analysis/weekly-oil-bulletin\\_en](https://ec.europa.eu/energy/data-analysis/weekly-oil-bulletin_en) nga data 16.11.2021) janë dhënë në tabelë në faqen e internetit të Komisionit Rregullator të Energjetikës dhe të Shërbimeve të Ujit të RMV-së [www.erc.org.mk](http://www.erc.org.mk).

22.11.2021

